



Agjencia Kombëtare e Rinisë

Termet e Referencës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Titulli i Pozitës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Kohëzgjatja

12 muaj

Vendndodhja

Agjencia Kombëtare e Rinisë, Tiranë

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) është institucion i cili garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështjetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

Konteksti

Këshilltari i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm.

Fokusi kryesor rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë mbi promovimi e përfitimeve të reformave, programeve dhe projekteve të mbështetura nga asistenca ndërkombëtare dhe rolin e aktiviteteve rinore që zbatohen nga AKR në kuadër të këtyre projekteve. Gjithashtu, Këshilltari do të ketë në fokus rritjen e transparencës dhe ndërveprimit të institucionit

Përshkrimi i Punës

- **Koordinon dhe ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm për vendimet dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare.**

Kryeni veprimet që lidhen me aktivitetet dhe rezultatet në kohë dhe në bashkëpunim me ekspertët e huaj. Siguron temat ndërsektoriale duke përfshirë risitë dhe vizionin e të rinjveve

- **Ekspertiza për përgatitjen dhe shkrimin e projekteve për Skemën e Granteve nga Bashkimi Evropian.**

Përgatitjen e raporteve financiare mbi projektet të jashtme dhe të brendshme

Mbështet me ekspertizë përgatitjen dhe shkrimin e projekteve

- **Koordinon, komunikon dhe u përgjigjet stafit të menaxhimit të projekteve për të arritur rezultatet e projektit.**

Udhëheq logjistikën për vizitat dhe mbështetje më të gjerë administrative Drejtorin e Përgjithshëm me palët e interesuara,

- **Menaxhon projektet me të cilat AKR ka përfituar prej projekteve ndërkombëtare në përputhje me rregulloret e donatorëve dhe procedurat e miratuara.**

Ndërlidh partnerët zbatues, duke siguruar etapat e zbatimit të projektit dhe monitorimin e rreziqeve;

Kualifikimet dhe Përvoja

- Minimumi 5 vite përvojë në fushën e promovimi e përfitimeve të reformave, programeve dhe projekteve të mbështetura nga asistenca ndërkombëtare
- Njohuri të thelluar të studimeve rinore.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale.
- Aftësi për të koordinuar dhe menaxhuar disa projekte në të njëjtën kohë.
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze.

Procesi i Aplikimit

- Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivuese duke detajuar përvojën e tyre relevante deri më datë 12.10.2025 ora 14:⁰⁰ në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Kriteret e Vlerësimit

- Kriteret për vlerësimin e aplikimeve do të jenë:
 - **Faza 1:** Kualifikimet dhe përvoja të cituara në piken Kualifikimet dhe Përvoja të këtij dokumenti;
 - **Faza 2:** Performanca në intervistë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.
(Aplikantët që kalojnë fazen e parë do lajmërohen zyrtarisht për ditën dhe orën e intervistës)

Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen deri më datë 12.10.2025 ora 14:⁰⁰ në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një punëdhënëse me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të organizatës.
